

I nderuar Ministër Hoti,

Të nderuar anëtar te Bordit të FSDK-së

E nderuara zj. Elena Petrovska, Udhëheqëse e Zyrës Rezidente të BERZH-it në Prishtinë

I nderuar z. Ilir Aliu, Kryetar i Bordit të Shoqatës së Bankave të Kosovës

Të nderuar përfaqësues të institucioneve vendore e ndërkombëtare

Të nderuar përfaqësues të mediave,

Zonja dhe zotërinj,

Kam kënaqësinë e veçantë t'ju drejtohem me këtë fjalë rasti lidhur me shënimin e kësaj ngjarje të një rëndësie të veçantë për Fondin e Sigurimit të Depozitave dhe për sektorin financiar në tërësi duke qenë se ky fond paraqet një rën nga komponentët kryesore të stabilitetit të sektorit financiar në Kosovë. Përveç që sot shënohet realizimi i një marrëveshje shumë të rëndësishme ndërmjet Fondit dhe BERZH-it për zhvillimin e sistemit të kompensimit të depozitave, kjo koïncidon edhe me pesë vjetorin e themelimit të këtij fondi ku do të shpaloiset edhe raporti për vitin 2015 me shumë të arritura gjatë këtyre pesë viteve të funksionimit. Kjo ngjarje është një vazhdimësi e sukseseve të arritura nga Fondi për Sigurimin e Depozitave që nga themelimi i tij, i cili është bërë i mundur me mbështetjen e Qeverisë Gjermane, të cilën shfrytëzoj rastin ta falënderoj për kontributin e dhënë që nga fillimi përmes KfË, por edhe Qeverisë së Kosovës për përkrahjen e dhënë për të arritur këtu ku jemi sot.

Ky vit ka shënuar edhe rritjen e shumës së siguruar të depozitave në 4,000 euro nga shuma e mëhershme prej 3,000 eurove, e cila sipas planifikimeve dhe duke marr parasysh të arriturat e deritanishme, do të rritet në nivelin prej 5,000 eurove duke filluar nga viti 2018, që paraqet një mbulueshmëri të kënaqshme për Kosovën edhe nëse bazohemi në praktikat e mira ndërkombëtare.

Për nivelin e zhvillimit të Fondit për Sigurimin e Depozitave flet edhe vlerësimi i pajtueshmërisë me Parimet Themelore për Sisteme Efektive të Sigurimit të Depozitave që i është bërë këtij Fondi vitin e kaluar nga ekspert ndërkombëtar të fushës me përfaqësues edhe të Agjencisë Ndërkombëtare të Siguruesve të Depozitave, i cili ka rezultuar se në pjesën më të madhe Fondi është në përputhje me këto parime. Kjo paraqet një rëndësi të veçantë për rritjen e sigurisë të sektorit financiar duke marr parasysh rolin e Fondit si një ndër katër shtyllat kyçe për mbështetjen efektive të stabilitetit të sektorit financiar, ku përveç Sigurimit të Depozitave hyjnë edhe Rregullative Prudenciale dhe Mbikëqyrja Efektive, Mekanizmat Efektiv të Administrimit të Bankave me Probleme dhe Kreditimi i Instancës së Fundit.

Që nga themelimi i këtij Fondi Banka Qendrore fillimisht si iniciues por edhe në hapat e mëtejme ka shfaqur gatishmërinë dhe përkushtimin që të mbështesë çdo aktivitet për zhvillimin dhe avancimin e mëtejme të tij, dhe njëkohësisht është për tu vlerësuar edhe angazhimi i personelit të Fondit për komunikim dhe bashkëpunim të ngushtë me Bankën Qendrore por edhe me palët tjera të interesit. Bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve është i plotësuar edhe me marrëveshjen e mirëkuptimit të nënshkruar më herët. Për një menaxhim të suksesshëm dhe efektiv të Fondit fletë edhe raporti i auditorit të jashtëm i cili i jep vlerësim pozitivë.

Marrëveshja e cila shënon këtë ngjarje ka një rol kyç pasi mundëson zhvillimin e njërit ndër faktorët kryesor që e bën një sistem të sigurimit të depozitave që të jetë efektiv në rolin e tij për mbrojtjen e depozitave dhe ruajtjen e sektorit financiar në rast të zhvillimeve të mundshme negative të ndonjë banke individualisht. Kjo për faktin se me anë të kësaj marrëveshje mundësohet avancimi i mëtejme i sistemit të kompensimit të depozitave në rastet kur është e nevojshme, i cili ndikon në shkurtimin e kohës dhe rritjen e efikasitetit në shpërndarjen e depozitave në rast nevoje. Ky është një faktor kyç që mundëson largimin e dyshimeve dhe pasigurisë së depozitorëve në rastet kur ndonjë bankë mund të hasë në vështirësi gjë që ndalon edhe veprimet e ashtuquajtura ngjitëse nga depozitorët tjerë duke ju mundësuar adresim të shpejtë të kërkesave të tyre. Kjo ndikon direkt në rritjen e besimit të depozitorët që është edhe faktori kryesor i stabilitetit financiar.

Në rolin e Bankës Qendrore që të siguroj stabilitetin e sektorit financiar çdo avancim i mëtejme i Fondit për Sigurimin e Depozitave sikurse që është ky, por edhe i secilës nga tri shtyllat tjera të referuara më lartë si pjesë e rrjetit të sigurisë e lehtësojnë dhe e bëjnë të mundshme mirëmbajtjen e këtij stabiliteti të sektorit financiar që e gëzojmë aktualisht. Të gjitha sistemet përfitojnë nga proceset e vazhdueshme të zhvillimit dhe përmirësimit.

Prandaj, shfrytëzoj rastin të falënderoj BERZH-in për mbështetjen e Fondit, si dhe Zj. Violeta Arifi-Krasniqi Drejtorin e Fondit, për angazhimin e palodhshëm dhe për organizimin e kësaj konference me që rast na ka mundësuar të shprehim qëndrimet tona dhe diskutojmë për çështje me rëndësi për sektorin financiar në Kosovë.

Dëshiroj që të jetë kjo një ngjarje me interes për ju, dhe të kaloni një ditë të mbarë.

Ju faleminderit.